



**Miratuar me vendimin nr. 55, datë 04.04.2016 të AMA-s, ndryshuar me
vendimin nr. 192, datë 19.12.2019 të AMA-s**

**RREGULLORE
PËR
DHËNIEN E LICENCAVE TË TRANSMETIMIT AUDIO TË KOMUNITETIT**

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit.

**Neni 2
Përkufizime dhe fusha e zbatimit**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
2. Dispozita e kësaj rregulloreje zbatohen për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit.

**Neni 3
Parime të përgjithshme**

Transmetimet komunitare janë transmetime audio për komunitetin të cilat:

- a. Ofrohen për zhvillimin social dhe përmbushjen e interesave të komunitetit;
- b. Reflekojnë nevojat kulturore, gjuhësore, etj...
- c. Ofrojnë programe në përputhje me interesat e komunitetit që i shërbejnë.
- d. Kanë karakter informues, edukativ dhe argëtues;
- e. Mbështeten në punën vullnetare të pjesëmarrësve të komunitetit;
- f. Krijojnë mundësi për të lejuar aksesin më të madh të mundshëm të gjithë pjesëmarrësve të komunitetit;
- g. Kanë struktura menaxhuese, përfaqësuese të komunitetit të cilit i shërbejnë.

**Neni 4
Kufizime**

Licenca e transmetimit audio të komunitetit lëshohet vetëm për:

- a. Komunitetin e organizuar dhe të regjistruar në formën e kërkuar ligjore.
- b. Bashkësinë fetare të organizuar dhe të regjistruar në formën e kërkuar ligjore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- c. Personat juridikë të krijuar prej komuniteteve fetare, institucione me struktura të organizuara dhe regjistruara në formën e kërkuar ligjore, me karakter fetar ose jofetar.

Neni 5

Karakteristikat e shërbimit audio të komunitetit

1. Licenca e transmetimit audio të komunitetit jepet në emër të subjektit aplikues.
2. Licenca e shërbimit audio të komunitetit përjashtohet nga detyrimet financiare për pagesat.
3. Shërbimi audio i komunitetit ofrohet pa qëllim fitimi dhe mbështetet në burime financiare të ligjshme.
4. Subjekti i licencuar për shërbimin audio të komuniteti nuk ka të drejtë të transmetojë reklama për qëllime fitimi.

Neni 6

Plani i frekuencave

1. Licenca e shërbimit audio të komunitetit jepet për një zonë gjeografike të caktuar.
2. AMA, në mënyrë periodike, duke pasur parasysh planin e përdorimit të frekuencave për transmetimet audio, përcakton frekuencat që do të shfrytëzohen për shërbimin audio të komunitetit si dhe zonën gjeografike të shërbimit.
3. AMA, gjatë planifikimit të përdorimit të frekuencave të destinuara për transmetime audio komunitare, cakton të paktën një mbulim me sinjal audio për çdo qark.

Neni 7

Cilësia e shërbimit

1. Mbulim me sinjal radio FM tokësore, sipas Rekomandimit ITU-R, BS 412-9 të ITU, do të konsiderohet mbulimi i zonës së licencimit me intensitet fushe jo më të vogël se:
 - 70 dB μ V/m (mono) dhe 74 dB μ V/m (stereo) për qytete të mëdha;
 - 60 dB μ V/m (mono) dhe 66 dB μ V/m (stereo) për zona urbane;
 - 48 dB μ V/m (mono) dhe 54 dB μ V/m (stereo) për zona rurale;
 - 34 dB μ V/m (mono) dhe 48 dB μ V/m (stereo) për zona të thella të Shqipërisë.
2. Subjekti i licencuar, bazuar në standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare, duhet të ofrojë shërbime audio me cilësi të lartë në zonën për të cilën është licencuar.
3. Pajisjet që do të përdoren duhet të projektohen, ndërtohen, mirëmbahen dhe shfrytëzohen në mënyrë që përdorimi i tyre të mos shkaktojë asnjë interferencë të dëmshme tek asnjë përdorues tjetër i spektrit të radiofrekuencave.

Neni 8

Standardet për programet

Subjekti i licencuar për transmetime audio të komunitetit është i detyruar të respektojë standardet e programeve, duke pasur parasysh:

- i. Ruajtjen e mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe në veçanti të drejtën e shprehjes dhe të informimit
- ii. Përmbushjen e nevojave, interesave, dhe promovimin e nismat të komunitetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- iii. Respektimin e paanshmërisë, plotësisë e pluralizmit të informacionit. Paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve në mënyrë të ndershme, inkurajimin në formimin e lirë të opinioneve, pa i shërbyer në mënyrë të njëanshme interesave të asnjë partie, organizate politike, grupimi ekonomik apo komuniteti e shoqate fetare;
- iv. Respektimin e mirëkuptimit dhe bashkekzistencës shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë;
- v. Promovimin e kulturës kombëtare shqiptare dhe gjuhës shqipe, si dhe të gjuhës, e kulturës së pakicave ;
- vi. Respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut;
- vii. Respektimin dhe mbrojtjen në veçanti të të drejtave të fëmijëve;
- viii. Respektimin e privatësisë së individit;
- ix. Respektimin e diversitetit fetar dhe racës;
- x. Respektimin e ruajtjen e sekretit të burimeve të informacionit;
- xi. Respektimin e normave morale dhe etike të shoqërisë;
- xii. Respektimin e të drejtës së përgjigjes.
- xiii. Respektimin e vlerave të fqinjësisë së mirë si dhe kërkesa të tjera, të përcaktuara në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 9

Çelja e konkurrimit

1. AMA, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, duke pasur parasysh ekzistencën e frekuencave të lira për transmetimet audio të komunitetit:
 - a. Përcakton hapësirën e mbulimit të licencës së transmetimit audio të komunitetit, për të cilën mund të aplikohet;
 - b. Çel garën për dhënien e licencës së transmetimit audio të komunitetit.
2. Për përcaktimin e hapësirës së mbulimit, AMA mban parasysh:
 - a. Interesat, pritshmërinë dhe dëshirat e publikut në këtë zonë mbulimi;
 - b. Ndikimin në sektorin e transmetimeve në këtë zonë;
 - c. Larminë e shërbimeve të programeve në zonën e mbulimit.

Neni 10

Shpallja e procedurës së licencimit

1. AMA shpall publikisht çeljen e garës për dhënien e licencës së transmetimit audio të komunitetit, në faqen e internetit të saj dhe në një organ shtypi, që shpërndahet në zonën e mbulimit të licencës së transmetimit.
2. Njoftimi për shpalljen e garës përfshin ftesën e të gjitha palëve të interesuara për të shprehur propozimet e tyre, në lidhje me natyrën e transmetimit audio të komunitetit, për të cilën është çelur gara. Në njoftim përcaktohen procedurat që duhen ndjekur për bërjen e aplikimit dhe kërkesat përkatëse.
3. Aplikimet për këtë licencë bëhen brenda 30 ditëve nga shpallja e garës dhe duhet të përshkruajnë mënyrën e planifikuar të ofrimit të shërbimit dhe plotësimin të kriterëve të shpallura paraprakisht nga AMA.



Neni 11

Tërheqja e dokumentacionit të konkurrimit

1. Subjektet e interesuara për t'u pajisur me licencë transmetimi audio të komunitetit duhet të pajisen me dokumentacionin e licencimit dhe të paraqesin aplikimin përkatës në vendin, datën dhe orën e përcaktuar në njoftimin për shpalljen e garës. Nuk pranohen aplikime pas mbarimit të afatit të paraqitjes së tyre.
2. Jo më vonë se 20 ditë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimit, subjektet, që kanë tërhequr dokumentacionin e konkurrimit, mund të kërkojnë sqarime me shkrim nga AMA për dokumentacionin e licencimit.
3. Sqarimet e bëra nga AMA mbi dokumentacionin e licencimit, pavarësisht kërkesës së një ose më shumë subjekteve, do t'u njoftohen të gjithë subjekteve që kanë tërhequr dokumentacionin e licencimit dhe do të publikohen në faqen zyrtare të AMA-s.

Neni 12

Aplikimi

1. Aplikimi duhet të përgatitet në përpunje me kërkesat e publikuara në dokumentacionin e licencimit. Dokumentacioni i aplikimit (dosja e aplikimit) duhet të jetë i mbyllur në një zarf të vulosur, firmosur dhe me mbishkrimin "Aplikim për licencë për shërbimin audio të komunitetit".
2. Aplikimi duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit dhe duhet të ketë adresën e saktë të subjektit aplikues.
3. Dokumentacioni i aplikimit nuk i kthehet aplikuesit.
4. Kandidati që ka dorëzuar dosjen e aplikimit para afatit të fundit të dorëzimit, kundrejt një kërkesë, ka të drejtë ta zëvendësojë ose ta tërheqë atë, me përjashtim të ditës së fundit të hapjes së dosjeve të aplikimit.
5. AMA, përpara mbarimit të afatit për paraqitjen e dokumentacionit të aplikimit (dosja e aplikimit), mund të zgjasë afatin e paraqitjes së tyre. Çdo zgjatje e tillë do t'i komunikohet menjëherë me shkrim kandidatëve që kanë tërhequr dokumentacionin e plotë të konkurrimit.

Neni 13

Dokumentacioni i aplikimit

1. Subjektet që aplikojnë për licencë transmetimi audio të komunitetit duhet të plotësojnë kërkesat për kualifikim si më poshtë:
 - 1.1 Të dhënat e aplikuesit:
 - a. Dokumentacionin për regjistrimin në formën e kërkuar ligjore;
 - b. Në rastin e personave juridikë të krijuar prej komuniteteve fetare me karakter fetar ose jofetar, edhe autorizimin e lëshuar prej bashkësisë fetare.
 - c. Autorizimin, ose prokurën e lëshuar prej subjektit aplikues për caktimin e personit përfaqësues të komunitetit aplikues për licencë transmetimi audio të komunitetit.
 - d. Vërtetim që personi i autorizuar nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

e. Të dhënat e kontaktit: Adresa, numri i telefonit, fax, e-mail;

1.2 Kërkesat teknike:

a. Objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit përfshirë mbulimin dhe interferencat

- (i) zona e mbulimit;
- (ii) të përcaktohet pika/t e transmetimit;
- (iii) të përcaktohet frekuenca/t e transmetimit;
- (iv) të përcaktohet fuqia/te e transmetimit;
- (v) të përcaktohet diagrama/t "H" dhe "V" të antenës/ave transmetuese;
- (vi) subjekti duhet të transmetojë sinjal RDS (sistem i të dhënave radio) në mënyrë që të identifikohet logoja e radios;
- (vii) Nëse për ofrimin e shërbimit nga studiot e subjektit deri në pikën e transmetimit do të përdoren lidhjet fikse (radiolink) subjekti duhet të aplikojë në AKEP për t'u pajisur me autorizimin përkatës.

b. Projektin dhe preventivin e rrjetit

- (viii) skema e organizimit
- (ix) projektet teknike të studiove;
- (x) projektet teknike të pikave të transmetimit,
- (xi) karakteristikat teknike të pajisjeve transmetuese, hartuar nga një subjekt i pajisur me licencë profesionale;

1.3 Kërkesat ekonomike:

- a. Dokumentacion i verifikueshëm mbi burimet e të ardhurave dhe përdorimin e tyre në funksion të ushtrimit të veprimtarisë objekt i dhënies së licencës nga AMA. Burimet e financimit duhet të paraqiten të detajuara për periudhën e vlefshmërisë së licencës.
- b. Parashikimet për shpenzimet dhe të ardhurat, shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen për të cilën jepet licenca, të cilat duhet të jenë në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë të subjektit aplikues.

1.4 Kërkesat programore:

- a. Struktura programore (e pasqyruar në raporte përqindjeje: si p.sh. informacion, kulturë-art; argëtim-zbavitje, programe për fëmijë; veprimtari sportive, promocion etj)
- b. Orët e transmetimit në një ditë (jo më pak se 6 (gjashtë) orë, ora e fillimit dhe mbarimit të transmetimit)
- c. Programi javor i transmetimit
- d. Përshkrimin e përmbajtjes së programeve kryesore që do të transmetohen.
- e. Përshkrimin e programeve që do trajtojnë aspekte të traditës e të aktualitetit të komunitetit.
- f. Pasqyrimi i kushtit që jo më pak 15% e kohës së transmetimit janë emisione të prodhuara vetë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

1.5 Të tjera:

- a. Të dhëna mbi numrin e punonjësve që do të punojnë në mënyrë vullnetare;
 - b. Informacion mbi mënyrën e organizimit të komunitetit;
 - c. Organigrama analitike e komunitetit;
 - d. Lista dhe CV-të e anëtarëve të Bordit Drejtues, minimumi, 5 anëtarë.
2. Aplikuesi duhet t'i përgjigjet çdo pyetjeje të autoritetit rregullator gjatë shqyrtimit të aplikimit.
 3. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues.
 4. AMA gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit për dhënien e licencës së transmetimit audio të komunitetit me karakter fetar, kërkon informacion për subjektet aplikues nga Komiteti Shtetëror i Kulteve, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Shërbimi Informativ Shtetëror dhe Policia e Shtetit.

Neni 14

Informacioni financiar

1. AMA ka të drejtë të kërkojë informacion mbi burimet financiare të subjekteve aplikues në mënyrë që të vlerësohet aftësia e tyre për kryerjen e shërbimit të propozuar.
2. Informacioni financiar i paraqitur në dosjen e aplikimit duhet të vërtetojë aftësinë e subjektit aplikues për të ngritur infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit të kërkuar.
3. Parashikimi për shpenzimet dhe të ardhurat duhet të parashikojë saktësisht nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të sigurohet që ky shërbim është i aftë të përmbushë objektivat e shërbimit.

Neni 15

Kriteret e vlerësimit të aplikimeve për licencë transmetimi

1. Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit bën, fillimisht, vlerësimin e përmbushjes së kërkesave ligjore të aplikimit.
2. Aplikimi që nuk përmbush kërkesat ligjore përjashtohet nga vlerësimi i mëtejshëm.
3. Aplikimi që përmbush kriteret ligjore, sipas kësaj rregulloreje, i nënshtrohet vlerësimit me pikë, sipas tabelës së mëposhtme:

1.	Vlerësimi i standardeve programore	40 pikë
2.	Vlerësimi i kritereve teknike	20 pikë
3.	Vlerësimi i kritereve financiare	20 pikë
4.	Burimet njerëzore	20 pikë

Neni 16

Shqyrtimi i kërkesave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

1. Shqyrtimi i aplikimit për licencë transmetimi audio të komunitetit, kryhet nga Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit.
2. Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit ngrihet me urdhër të Kryetarit dhe përbëhet nga Kryetari i Komisionit dhe Drejtorët e Drejtorive të AMA-s. Kryetar i Komisionit është zëvendëskryetari i AMA-s, ose çdo nëpunës tjetër i autorizuar prej Kryetarit.
3. Anëtarët e Komisionit shqyrtojnë të dhënat e paraqitura nga subjektet.
4. Anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, sipas kompetencës, përgatitin relacionet e vlerësimit. Rezultatet e vlerësimit me pikë, i paraqiten AMA-s në një raport të shoqëruar nga një tabelë përmbledhëse ku aplikuesit renditen sipas numrit të pikëve të grumbulluara.
5. AMA miraton procedurat e ndjekura dhe vlerësimin me pikë në një mbledhje të veçantë. AMA në rast se konstaton mangësi në respektimin e procedurave dhe vlerësimit, ka të drejtë të drejtë të kërkojë kryerjen e një vlerësimi të ri.
6. Anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit mbajnë përgjegjësi për saktësinë e përpunimit të të dhënave të akteve të sipërcituara si dhe për ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve me të cilat njihet gjatë këtij procesi.
7. Informacionet në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve nuk duhet t'u bëhen të njohura aplikuesve a personave të tjerë, që nuk janë të angazhuar zyrtarisht në këtë proces.

Neni 17

Vendimi për dhënien e licencave të transmetimit audio të komunitetit

1. AMA vendos për dhënien ose jo të licencës së transmetimit audio brenda 60 ditëve nga data e caktuar prej saj, sipas nenit 11, pika 1 të kësaj rregulloreje.
2. Refuzimi nga AMA i aplikimit për shërbimin e transmetimit audio të komunitetit, bëhet gjithmonë kundrejt një vendimi të arsyetuar.
3. Kundër vendimit të AMA-s sipas këtij neni, aplikuesi mund të bëjë ankim në gjykatë, sipas, ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Neni 18

Afati i licencave të transmetimit audio të komunitetit

1. Licenca e transmetimit audio të komunitetit jepet me afat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë rinovimi.
2. Subjekti i licencuar për shërbimin e transmetimit audio të komunitetit është i detyruar që, brenda 3 mujorit të parë të çdo viti, të paraqesë informacionin mbi burimet e të ardhurave, të detajuara në shumat përkatëse dhe shpenzimet që lidhen me objektin e marrjes së licencës nga AMA.

Neni 19

Rinovimi i licencës

1. Aplikimi për rinovimin e licencës së transmetimit audio të komunitetit duhet të bëhet të paktën 90 ditë përpara përfundimit të afatit të licencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

2. Kërkesat e aplikimit për rinovimin e licencës së transmetimit audio janë të njëjta me atë të aplikimit fillestar.
3. Aplikimi i subjektit që është dënuar me gjobë, që ka marrë formë të prerë, por nuk e ka paguar atë, refuzohet.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të AMA-s.